



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

**VENDIM**

**Nr. 82/2020**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 92/2017  
“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS  
DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOLEGJIT TË  
POSAÇËM TË APELIMIT,” TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të nenit 18, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

I. Miratohen ndryshimet në strukturë, organikë dhe klasifikimin e pagave të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

II. Organika dhe klasifikimi i pagave të personelit është sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Struktura organizative është sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi

IV. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2021.

**K R Y E T A R I**

**Gramoz RUÇI**

Miratuar në datën 23.12.2020

**ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOLEGJI I POSAÇËM I  
APELIMIT**

<b>FUNKSIONI ORGANIK</b>	<b>Klasifikimi i pagës</b>	<b>Numri</b>
		<b>(2)</b>
<b>I. KRYETAR</b>	<b>G3*</b>	<b>1</b>
Sekretar	Sekretar në kabinetin e kryetarit të Kuvendit**	1
<b>II. KOLEGJI I GJYQTARËVE</b>		<b>(6)</b>
Gjyqtarë	G3*	6
<b>III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR</b>		<b>(20)</b>
Këshilltarë jurist	80% e pagës G3*	11
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	9
<b>IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM</b>	<b>I-a</b>	<b>1</b>
<b>V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN</b>		<b>(11)</b>
Drejtor	II-b	1
Specialist sekretarie gjyqësore	III-b	3
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	IV-a	1
Përkthyes	II-b	4
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a	1
Specialist pritje me popullin	IV-a	1
<b>VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE</b>		<b>(9)</b>
Drejtor	II-b	1
Specialist financë/buxhet	III-b	1
Specialist i burimeve njerëzore	III-b	1
Specialist IT ***	III-b	2
Specialist protokoll/arkivë ****	IV-a	1
Magaznier	VII	1

Punonjës pastrimi	III	1
Shofer/ Korrier	VI	1
<b>Total</b>		<b>49</b>

*Shënim:*

*\*Sipas ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

*\*\*Kategoria e pagës për sekretarin e Kryetarit është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

*\*\*\* Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

*\*\*\*\* Punonjësit në pozicionet specialist arkivi, përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

*\*\*\*\*\* Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore*

**STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT**

